

Prof. Dr. Dhimitër Dhora

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”
Fakulteti i Shkencave të Natyrës
Departamenti i Biologji-Kimisë

FJALOR
i emrave të kafshëve
të Shqipërisë

latinisht-shqip-anglisht



Botimet “Camaj-Pipa”

Prof. Dr. Dhimitër Dhora
Fjalor i emrave të kafshëve të Shqipërisë
latinisht-shqip-anglisht

Grafika:
Gjergj Spathari

ISBN 978-99956-02-61-1

©Copyright: Dh. Dhora

Përmbajtja

Parathënie	5
Latinisht-shqip-anglisht	7
Shqip-latinisht	142
Anglisht-latinisht	211
Latinisht, në renditje sistematike	248
Literaturë	284

Parathënie

Në shekullin e fundit është bërë një punë e madhe për grumbullimin dhe pasqyrimin në fjalorë të emrave shqip të kafshëve dhe këtu mund të veçoj fjalorët e Gazullit (1942) dhe Demës (2005), Fjalorin e Shqipës së Sotme (2002) e tj. Nga ana tjetër në shumë fauna të ndryshme të Shqipërisë janë dhënë edhe emrat shqip të llojeve të kafshëve, si tek Bino e tjerë (2006) për shpendët dhe gjitarët, Poljakov e tjerë (1958) dhe Rakaj (1995) për peshqit e tjerë. Mirëpo në të gjitha rastet vërehet mungesa e një bashkëpunimi të frytshëm të gjuhëtarëve me specialistët faunistë, çka duket tek mungesa e specifikimit dhe shpjegimit të saktë të emrave, ose tek varfëria e emrave, për shkak të mosnjohjes së fondit të tyre.

Nevojat për të zgjidhur në tërësi këto probleme dhe për ti dhënë lexuesve një fjalor sa më të plotë, kanë qenë motivet kryesore të punës për hatimin e tij dhe për të qënë më i vlefshëm, u hartua në tre gjuhë, latinisht – shqip – anglisht.

Ky fjalor përmban emrat e 1140 llojeve të kafshëve të Shqipërisë. Këtij numri llojesh i përkasin 2178 emra në shqip. Në latinisht dhe anglisht numri i emrave në fjalor është po aq sa i llojeve, pasi çdo lloji i përgjigjet një emër. Emrat shkencorë të kafshëve në latinisht janë aktualë, të marrë prej literaturës shkencore bashkëkohore. Në anglisht janë përzgjedhur emrat më të njohur dhe më të përdorur, më të përshtatshëm në kuptimin gjuhësor, biologjik e gjeografik për këtë fjalor.

Llojet e kafshëve të Shqipërisë që përfshihen në fjalor janë përzgjedhur nga studimet e deritanishme, duke shfrytëzuar edhe përvojën e grumbulluar prej katër dekadash në njohjen e faunës. Në fjalor përfshihet shumica dermuese e llojeve të kafshëve vertebrorë të Shqipërisë, ndërsa nga invertebrorët janë përzgjedhur llojet më të zakonshme, më të rëndësishme, më të njohura.

Emrat shqip të kafshëve janë marrë prej fjalorëve të ndryshëm

shqip, përfshirë edhe ata krahinorë dhe të fjalëve të ralla, nga studime të ndryshme të karakterit gjuhësor, nga faunat dhe studimet faunistike të bëra deri më sot në Shqipëri, si dhe nga kërkimet tona në këtë fushë. Ata nuk janë përpunuar nga pikëpamja gramatikore. Nuk janë rregulluar trajtat e emrave, për shkak të mosnjohjes së gjinive të shumë prej tyre. Gjithashtu një punë e madhe është bërë për të specifikuar emrat, duke kërkuar që çdo lloj të ketë emrin e vet. Gjatë kësaj pune janë bërë mjaft korrigjime, saktësime, rregullime të sinonimive dhe homonimive. Në mjaft raste kur emrat tregojnë taksonin e gjinisë apo taksa më të larta, përdorimi i emrit është bërë kryesisht tek lloji tipik, apo më i njohur. Në emrat e kafshëve, të shqipëruara nga autorë të ndryshëm, kemi bërë disa modifikime përmirësuese.

Fjalori i kafshëve invertebrore është pasuruar ndjeshëm. Emërtimi i tyre është bërë nëpërmjet përpunimit racional të fondit ekzistues të emrave, harmonizimit të kuptimit biologjik të llojit me kuptimin e emrit në gjuhët e huaja, sidomos në latinisht, anglisht dhe gjuhëve të lokaliteteve tipike të llojeve.

Siç shihet tek faqja që tregon përmbajtjen, fjalori ka katër pjesë: emrat e llojeve të kafshëve të Shqipërisë në latinisht-shqip-anglisht, shqip-latinisht, anglisht-latinisht, si dhe në latinisht në renditje sistematike.

Për realizimin cilësor të këtij fjalori është realizuar një vëllim i madh pune në kompjuter, ku një kontribut të rëndësishëm ka dhënë Dritan Dhora.

Shpresoj se ky fjalor do të ndihmojë dhe lehtësojë punën e studiuesve, studentëve dhe nxënësve, mësuesve, kryesisht atyre të biologjisë, gjuhës shqipe dhe angleze, njerëzve që merren me projekte ekologjike, ambientalistëve e tj. Nëse fjalori do të gjejë përdorim të gjerë, atëherë edhe vërejtjet e propozimet që mund të bëhen me siguri do të vlejné që ribotimet të jenë më të arritura.

Autori

Latinisht-shqip-anglisht

A

Ablepharus kitaibelii

Zhapiu këmbëvogël

Snake-eyed skink

Acanthocardia tuberculata

Midhja zemër me gunga

Tuberculate cockle

Accipiter brevipes

Gjeraqina këmbëshkurtër

Levant sparrowhawk

Accipiter gentilis

Gjeraqina

Goshawk

Accipiter nisus

Gjeraqina e shkurtës, pitajku

Sparrowhawk

Acherontia atropos

Flutura me kafkë, flutura me kokëvdekuri, turraqi

Death's head hawkmoth

Acheta domestica
Bulkthi i shtëpisë, grylli
House cricket

Acipenser naccarii
Blini i Drinit, blini i bardhë, blini i Adriatikut
Adriatic sturgeon

Acipenser stellatus
Blini me yje, blini turigjatë
Starry sturgeon

Acipenser sturio
Blini, blini i Europës Perëndimore
Sturgeon

Acrida bicolor
Karkaleci turigjatë
Becoloured acrid

Acrocephalus melanopogon
Bilbilthi me mustaqe, cika me mustaqe, cijka me mustaqe,
çika me mustaqe
Moustached warbler

Acrocephalus arundinaceus
Bilbilthi fushor i kallamave, çika e gjerdheve
Great reed warbler

Acrocephalus palustris
Çika e verdheme, bilbilthi i verdhemë, bilbilthi i kënetave
Marsh warbler

Acrocephalus schoenobaenus

Bilbilthi i zhukave, çika e zhukave

Sedge warbler

Acrocephalus scirpaceus

Rogozhari cicerues, bilbilthi i kallamave, çika e kallamishteve, çika e verdhë

Reed warbler

Acrotylus longipes

Karkaleci këmbëgjatë, karkaleci krahëverdhë i ranishteve

Yellow-winged sand grasshopper

Actinia equina

Anemonia e kuqe, thundërkali e kuqe

Beadlet anemone

Actitis hypoleucos

Qyrylyku i vogël

Common sandpiper

Adalia bipunctata

Buburreci dypikësh

Two-spotted ladybird

Adamsia palliata

Anemonia mantelore

Hermit crab anemone

Adelphocoris lineolatus

Çimka e jonxhës

Alfalfa plant bug

Aegithalos caudatus

Trishtili bishtgjatë

Long tailed tit

Aegyptius monachus

Shkaba e zezë

Black vulture

Aelia rostrata

Breshka e drithrave

Wheat stink bug

Agriotis lineatus

Kërcitesi i krimbit tel

Wireworm

Agrotis segetum

Flutura e krimbit të murmë

Turnip moth

Alauda arvensis

Lauresha, larushja, çerdhukla

Skylark

Alburnoides bipunctatus

Barkgjera, gjuca e lumit, skorta me vizë, cimja

Spirlin

Alburnus alburnus

Gjuca, gjuhca, gjumca, pllashica, korobacja

Bleak

Alburnus belvica

Gjuca e Prespës, cironka, ciroja, miskra (i vogli), pllashica

Macedonian bleak

Alcedo atthis

Bilbili i ujit, bylbyli i ujit, martin peshkatari, mulliujca, mëlliujca, mullënja peshkatore, skjepgjata
Kingfisher

Alcyonium palmatum

Korali i butë
Soft coral

Alectoris graeca

Thëllëza e malit, fëllanza e malit, fllanxa e malit, thëllënza me gjerdan, thëllanxa, këmbëkuqja
Rick partridge

Algyroides nigropunctatus

Hardhuca e shkëmbinjve, hardhuca pikazezë
Dalmatian algyroides

Alopias vulpinus

Peshku dhelpër, peshkaqeni dhelpër, peshkaqeni bishtshpatë
Thresher shark

Alosa agone

Kubla, kulba, melca-kubël deri katër muajshe, lloça-kubël katër muajshe deri në një vjeçe, straga-kubël një vjeçe deri në moshën e pjekurisë seksuale, maçka (kubël e vogël)
Twaite shad

Ameiurus melas

Peshku mace e zezë
Black bullhead

Ameiurus nebulosus

Peshku mace kafe
Brown bullhead

Amophila sabulosa
Grethi belgjatë i vemjeve
Thread-waisted wasp

Amphimallon solstitialis
Zhuzhaku i qershorit
June chafer

Anacridium aegyptium
Karkaleci egjyptian
Egyptian locust

Anas acuta
Rosa bishtgjele, bishtrra, bishtagjeli
Pintail

Anas clypeata
Sqepluga, rosa sqeplugë
Shoveler

Anas crecca
Rosa kërre, kërrkërrja, gërxhola, gërzhola, gëzhollja, grzholla
Teal

Anas penelope
Kryekuqja e madhe, rosa kryekuqe, rosa e detit, rosa kokë-
madhe
Wigeon

Anas platyrhynchos
Rosa jeshile (mashkulli), kuqëla (fëmra), rosa e vendit, rosa e
egër
Mallard

Anas querquedula
Marsakja, marsatorja
Garganey

Anas strepera
Rosa e përhime
Gadwall

Anax imperator
Pilivesa perandorake
Emperor dragonfly

Anemonia sulcata
Anemonia kaçurrele
Snakelock anemone

Anguilla anguilla
Ngjala, gjala, njala, mesholla
European eel

Anguis fragilis
Kakëzogëza, kakroga
Slow worm

Anilocra physodes
Morri i peshkut
Fish flea

Anisoplia austriaca
Buburreci austriak, zhuzhaku i drithrave
Cereal beetle

Anodonta cygnaea
Midhja pa dhëmbë, midhja e pellgjeve
Swan mussel

Anomala vitis

Brumbulli i gjelbër, zhuzhaku i hardhisë

Vine chafer

Anomia ephippium

Gurca si shale

Saddle oyster

Anopheles maculipennis

Mushkonja e malaries

Malarien mosquito

Anser albifrons

Pata ballbardhë, pata belbe, pata memece, belbacuke, belbeja

White fronted goose

Anser anser

Pata e vendit, pata kullashe, pata e egër

Greylag goose

Anser erythropus

Pata e vogël

Lesser white fronted goose

Anser fabialis

Pata e arave

Bean goose

Anseropoda placenta

Ylli këmbëpatë

Goose foot starfish

Antedon mediterranea

Zambaku i Mesdheut, krfori mesdhetar

Mediterranien featherstar

Anthias anthias

Kerr i kuq, peshku bishtdallëndyshe

Swallowtail seaperch

Anthocaris cardamines

Aurora

Orange tip

Anthus campestris

Drenja e fushës

Tawny pipit

Anthus cervinus

Drenja gushëkuqe

Red throated pipit

Anthus pratensis

Drenja e luadhit

Meadow pipit

Anthus spinoletta

Drenja e malit

Rock pipit

Anthus trivialis

Drenja e pyllit

Tree pipit

Aphanius dispar

Çeliku laraman

Killifish

Aphanius fasciatus

Çeliku me rripa

Mediterranean toothcarp

Aphanius iberus
Larëza iberike
Spanish toothcarp

Aphrodite aculeate
Shumëketëshi i trashë, miu i detit
Sea mouse

Apis mellifera
Bleta, mjalca, mjaltëza, berceku (mashkulli), bër bani (mash-
kulli), bonja (femra), farja (matka), parëza
Western honeybee

Aplexa hypnorum
Kërmilli meshikëz i lëmashkut
Moss bladder snail

Aplysia punctata
Lepuri i detit
Dotted sea-hare

Apodemus flavicollis
Miu gushëverdhë, bokrra
Yellow necked mouse

Apodemus sylvaticus
Miu bishtgjatë i pyllit
Long tailed field

Apogon imberbis
Peshku kardinal, mbreti i gjelave, kuqrraku
Cardinal fish

Aporia crategi

Flutura e pemëve

Black-veined white

Aporrhais pespelecani

Kërmilli këmbëpelikan

Pelican's foot

Apus apus

Dejka

Swift

Apus melba

Dejka gjoksbardhë, dejka e malit

Alpine swift

Aquila chrysaetos

Shqiponja e malit, shqipja e malit (shkypja, shqypja)

Golden eagle

Aquila clanga

Shqiponja e madhe e rosave, shqipja e rosave

Spotted eagle

Aquila heliaca

Shqiponja perandorake, shqipja perandorake

Imperial eagle

Aquila pomarina

Shqiponja e vogël e rosave, shqipja e vogël

Lesser spotted eagle

Arbacia lixula

Iriqi i zi i detit, gështënja e detit, ferrçori i zi

Black urchin

Arca noae
Midhja varkë e noes
Noah's ark

Arctia caja
Flutura tigër
Garden tiger moth

Arcyptera fusca
Karkaleci shumëngjyrësh
Tooth-legged grasshopper

Ardea cinerea
Çafka e përhime, çapka e përhime, gatëza e përhime, gata e përhime, çajmja e përhime, çapëthemja, çapa e përhime, boroviçi
Grey heron

Ardea purpurea
Çafka e kuqerreme, çapka e rrushit
Purple heron

Ardeola ralloides
Çafka e verdhë, çapka e verdhë
Squaco heron

Arenaria interpres
Gjelëza laramane
Turnstone

Arenicola marina
Shumëketëshi i rërave
Lugworm

Argentina sphyraena
Trofta e detit, argjendina
Argentine

Argynnis paphia
Flutura njollëargjendë
Silver washed fritillary

Argyrosomus regius
Ameja, orli i detit
Meagre

Armadillidium vulgare
Dokri, dosta
Roly poly

Arnoglossus imperialis
Gjuhëzë perandorake
Imperial scaldfish

Arnoglossus kessleri
Gjuhëza e Keslerit, gjuhëza e barit
Scaldback

Arnoglossus laterna
Gjuhëza gojëmadhe
Scaldfish

Arnoglossus rueppelli
Gjuhëza e Rypelit, gjuhëza e bardhë
Rüppell's scaldback

Arnoglossus thori
Gjuhëza e Torit, gjuhëza e egër, gjuhëza bajraktare
Thor's scaldfish

Aromia moschata
Antenëgjati me aromë
Musk beetle

Ascidia mentula
Ashidie rozë
Pink sea squirt

Asio flammeus
Bufi veshshkurtër, bufa
Short eared owl

Asio otus
Bufi veshgjatë, hutini i vogël
Long eared owl

Aspitrigla cuculus
Peshku gjel i kuq, peshku qyqe
Red gurnard

Aspitrigla obscura
Peshku gjel-dallëndyshë, peshku gjel pendëgjatë
Longfin gurnard

Asselus aquaticus
Morr uji
Water slater

Astacus fluviatilis
Gaforrja e lumit
Broad-fingered crayfish

Asterina gibbosa
Yll deti jastëkor
Cushion star

Astraea rugosa
Kërmilli i kuq me rudha
Rough star shell

Astropecten aranciacus
Ylli i madh krëhëror
Ochre hackled starfish

Astropecten irregularis
Ylli deti i rërave
Sand star

Astropecten spinulosus
Yll deti me thepa
Beaded sea star

Athene noctua
Kukuvajka, kukuvaca, furuvejka, huruvejka, kukumjaçka,
kukunjaçka, kukuvaja, druca, verrkeqja
Little owl

Atherina boyeri
Aterina symadhe
Big scale sand smelt

Atherina hepsetus
Aterina, terina, gavoni
Mediterranean sand smelt

Aulopus filamentosus
Peshku bajrak
Royal flagfin

Aurelia aurita
Meduza hënë
Moon jellyfish

Auxis rochei
Toni ngjyrë plumb, trupi, skumbri i madh
Bullet tuna

Axinella verrucosa
Sfungjeri gishtor
Finger sponge

Aythya ferina
Kryekuqja e mjeme, kryekuqi
Pochard

Aythya fuligula
Rosa laramane me çafkë, balisha
Tufted duck

Aythya marila
Rosa kredharake, rosa zhytëse, laramani
Scaup

Aythya nyroca
Kryekuqja e vogël
Ferruginous duck

B

Bacillus rossi
Kandërdegëza
Mediterranean stick insect

Balanus perforatus
Gaforre guaskëlozhere
Corn barnacle

Balistes carolinensis
Peshku derr
Grey triggerfish

Barbatula barbatula
Tufëza, mrena e egër
Stone loach

Barbus albanicus
Mrena shqiptare
Albanian barbel

Barbus peloponnesius
Mrena, mrena ballkanike, mustaku i lumit, shkabona
Peloponese's barbel

Barbus prespensis
Mrena e Prespës
Prespa's barbel

Belone belone
Peshku lejlek
Garfish

Bembex mediterranea
Grethi i rërave
Mediterranean sand wasp

Blaps lethifera
Trupziu me bisht
Blunt-tailed blaps

Blatta orientalis

Bumella, bumalla, buxhuleku, kacabuni, furrëtarja e zezë
Oriental cockroach

Blattella germanica

Furrëtarja prusiane, bumellëza
German cockroach

Blennius ocellaris

Barburiqi i detit, barburiqi flutur
Butterfly blenny

Bombina variegata

Bretkoca barkverdhë
Yellow –bellied toad

Bombus lapidarius

Polenizuesi bishtkuq
Red-tailed bumblebee

Bombus terrestris

Bubaçi, polenizuesi i tokës
Buff-tailed bumble bee

Bombycilla garrulous

Çafkëlorja bishtverdhë, kaçubla
Waxwing

Bombylius major

Miza leshtake trombëgjatë
Great beefly

Bombyx mori

Flutura e mëndafshit
Silkmoth

Bonasia bonasia
Pula me çafkë, pula e egër
Hazel grouse

Boops boops
Vopa, tonovili
Bogue

Botaurus stellaris
Gakthi
Bittern

Bothus podas
Shkotra kukuvajkë
Wide-eyed flounder

Botryllus schloeri
Ashidie yllore
Star ascidian

Branta ruficollis
Pata e vogël laramane, pata gushëkuqe
Red breasted goose

Bubalus bubalis
Bualli, buelli
Water buffalo

Bubo bubo
Bufi, bufi i madh me veshë, hutini i madh, hutini me veshë, lorja
Eagle owl

Bucephala clangula
Rosa me katër sy
Goldeneye

Bufo bufo
Thithlopa, bllaçkëlopa
Common toad

Bufo viridis
Zhaba, zhaba e gjelbër
Green toad

Buglossidium luteum
Gjuhëza e verdhë, gjuhëza e vogël
Solenette

Bulla striata
Bushiç deti
Atlantic bulla

Bunodactis verrucosa
Anemonia kokërrizore
Gemm anemone

Burhinus oediconemus
Gjelaci symadh
Stone curlew

Buteo buteo
Huta, orli, petriti minjngënës
Common buzzard

Buteo lagopus
Huta me kalca
Rough-legged buzzard

Buteo rufinus
Huta bishtbardhë, petriti bishtbardhë
Long legged buzzard

Buthus occitanus
Akrepi i rëndomtë
Common scorpion

C

Calandra granaria
Turigjati i grurit
Grain weevil

Calandra oryzae
Turigjati i misrit
Rice weevil

Calandrella brachydactyla
Larushëza
Short toed lark

Calappa granulata
Gërthia shpinëkokërrizore
Shamefaced crab

Calidris alba
Gjelaci i rërës
Sanderling

Calidris alpina
Gjelëza gushëzezë, gjelaci barkzi
Dunlin

Calidris minuta
Gjelaci i vogël
Little stint

Callanthias rubber

Peshku papagal

Parrot seaperch

Calliactis parasitica

Anemonia hermite

Hermit anemone

Callionymus lyra

Peshk-pilivesa, peshk-pilivesa lire

Dragonet

Callionymus maculatus

Peshk-pilivesa mozaik

Spotted dragonet

Callionymus risso

Peshk-pilivesa me pika

Spotted dragonet

Calliophora erythrocephala

Miza e mishit

Blowfly

Calliptamus italicus

Karkaleci italian, çikrra italiane, kacaleti italian, kacaleci italian

Italian locust

Callista chione

Flegërtrasha e lëmuar

Smooth clam

Calonectris diomedea

Lajmëtari i madh i fortunes

Cory,s shearwater

Calopteryx splendens
Bukuroshja vezulluese
Banded demoiselle damselfly

Calopteryx virgo
Bukuroshja flatrablu
Beautiful demoiselle damselfly

Calosoma sycophanta
Zhuzhinga erëkeqe
Forest caterpillar hunter

Canis lupus
Ujku
Wolf

Canius aureus
Çakalli, çangalluja
Jackal

Capnodis cariosa
Buburreci kokërrizor, brumaçi
Pistachio root beetle

Capnodis tenebrionis
Brumaçi drubirues
Peach capnodis

Capreolus capreolus
Kaprolli, sorkallja, krapuolli
Roe deer

Caprimulgus europaeus
Dallëndyshja nate, lorëza
European nightjar

Capros aper
Peshku bilbil, peshku tambur
Boarfish

Carabus coriaceus
Bubuzheli koracëfortë, zhuzhinga koracëfortë
Ground beetle

Carabus granulatus
Bubuzheli i bronxtë, zhuzhinga i bronxtë
Bronze beetle

Carabus violaceus
Bubuzheli vjollcë
Violet ground beetle

Carapus acus
Peshku bishthollë
Pearlfish

Carassius auratus
Karasi i artë, peshku i kuq
Goldfish

Carassius carassius
Karasi, karasi i bronxtë
Crucian carp

Carassius gibelio
Karasi prusian
Prussian carp

Carcharhinus melanopterus
Peshkaqeni pendëzi
Blacktip reef shark

Carcharhinus plumbeus

Peshkaqen i hirtë

Sandbar shark

Carcharodon carcharias

Peshkaqen njeriingrënës

Great white shark

Carcinus aestuarii

Gërthia e barishteve, gredhja e barishteve

Green crab

Carduelis cannabina

Kërpngrënesi, gardalina e kërpit

Linnet

Carduelis carduelis

Gardalina

Goldfinch

Carduelis chloris

Vërdulli, verduni, varduni, vardoi

Greenfinch

Carduelis spinus

Cërla dimërake, gardalina dimnake, çkilifini

Siskin

Caretta caretta

Breshka e detit

Loggerhead turtle

Carpocapsa pomonella

Flutura e krimbit të mollës

Codling moth

Carpocoris fuscispinus

Çimka erëkeqe

Stink bug

Cassida nebulosa

Breshkëza e panxharit

Tortoise beetle

Centrolophus niger

Murroku

Blackfish

Centrophorus granulosus

Peshkaqeni gllabërues, peshkaqeni kokërrzor

Gulper shark

Cepaea vindobonensis

Kërmilli me shirita

Viennese banded snail

Cepola macrophthalma

Peshk shirit, peshk shirit i kuq, peshk shirit i zakonshëm

Red bandfish

Cerambyx cerdo

Brisqari

Great capricorn beetle

Cerastoderma edule

Midhja zemër e zakonshme

Common cockle

Cerastoderma glaucum

Midhja zemër e lagunave

Lagoon cockle

Ceratitis capitata
Miza e Mesdheut
Mediterranean fruit fly

Cercopis sanguinea
Gjinkallëza e kuqe
Froghopper

Cerithium vulgatum
Kërmilli karficë
European common cerith

Cernuella virgata
Kërmilli i djerrinave ranore
Sand heath snail

Certhia familiaris
Piku rrotullues, kacavjerrësi
Treecreeper

Cetonia aurata
Zhuzhaku i artë, vizha, bubuzhinga, zhuzhinga
Common rose beetle

Cetorhinus maximus
Peshkaqeni gjigant
Basking shark

Cettia cetti
Bilbili i kënetave
Cetti's warbler

Chamelea gallina
Venusi me shirita
Striped venus clam

Charadrius alexandrinus
Vrapuesi gushëbardhë
Kentish plover

Charadrius dubius
Vrapuesi i vogël
Little ringed plover

Charadrius hiaticula
Vrapuesi qafëzi
Ringed plover

Charonia variegates
Tritoni laraman
Atlantic triton's trumpet

Cheilopogon exsiliens
Peshku fluturues i hirtë
Bandwing flyingfish

Cheilopogon heterurus
Peshku fluturues i Mesdheut
Mediterranean flyingfish

Chelon labrosus
Qefulli i dimrit, vijoshi, mavriaku
Thicklip grey mullet

Chelonia mydas
Breshka e gjelbërt e detit
Green turtle

Chimaera monstrosa
Peshku lepur
Rabbit fish

Chlamys opercularis
Freskorja e mbretëreshës
Queen scallop

Chlamys varia
Freskorja e larmishme
Variegated scallop

Chlidonias hybridus
Dallëndyshja e detit gushëbardhë
Whiskered tern

Chlidonias leucopterus
Dallëndyshja e detit krahëbardhë
White-winged black tern

Chlidonias niger
Dallëndyshja e detit e zezë
Black tern

Chlopsis bicolour
Murena dyngjyrëshe, ngjala dyngjyrëshe
Bicoloured false moray

Chlorophthalmus agassizi
Syjeshilja
Shortnose greeneye

Chondrostoma nasus
Njila, skobusi, buzëstaku, buztaku, peshku gojëkuti, njilatra
(njilë e madhe)
Sneep

Chondrostoma prespense

Njila e Prespës

Prespa's sneep

Chromis chromis

Peshku gështenjë

Damsel fish

Chrysaora hysoscella

Meduza këlyshlindëse

Compass jellyfish

Chrysomela violacea

Buburreci vjollcë

Violet leaf beetle

Chrysopa vulgaris

Krahëdantella e gjelbër

Green lacewing

Chrysops pictus

Muriela e murme

Deer fly

Cicada orni

Gjinkalla, cinxëri, çikallja, çikalla, kërngalla, gungalla

Mediterranean cicada

Cicadella viridis

Gjinkallëza e gjelbër

Green leafhopper

Cicadetta montana

Gjinkallëza e malit

Mountain cicada

Cicindela campestris

Kërcyesi i fushës
Green tiger beetle

Cicindela hybrida

Kërcyesi i ranishteve
Dune tiger beetle

Ciconia ciconia

Lejleku, lejleku i bardhë, kanusha, kanjusha, shtergu, shterku
White stork

Ciconia nigra

Lejleku i zi
Black stork

Cidaris cidaris

Iriqi i detit me purteka
Pencil spine urchin

Cimex lectularius

Çimka e njeriut, çimrra, çimçi, çymçi, pulina, pulika, tartabiqja
Bed bug

Cinclus cinclus

Mëllënja e ujit
Dipper

Circaetus gallicus

Shqiponja gjarpërngrenëse, shqipja e gjarpinjve
Shorttoed eagle

Circus aeruginosus

Shqipja e kënetave
Marsh harrier

Circus cyaneus
Shqipja e fushës
Hen harrier

Circus macrourus
Shqipja e zbehtë, shqipja e stepave
Pallid harrier

Circus pygarcus
Shqipja e baltakëve
Montagu's harrier

Citharus linguatula
Paroshja
Atlantic spotted flounder

Cladocora cespitosa
Madrepora mesdhetare
Living roch coral

Cleonus mendicus
Turigjati i panxharit
Sugar-beet weevil

Clytra quadripunctata
Buburreci katërpikësh
Four spotted leaf beetle

Cobitis meridionalis
Mrena e egër e Prespës
Prespa's loach

Cobitis taenia
Mrena e egër
Spined loach

Coccinella septempunctata

Nusepashkja, shtatëpikaloshja, mollëkuqja, buburiza, buburre-
zjabuburiska, bubureza
Seven-spotted ladybird beetle

Coccothraustes coccothraustes

Kryemadhi, sqeptrash, kobeci
Hawfinch

Coelorhynchus coelorhynchus

Granadieri njollazi, granathedhësi fytzi, granadieri bishtgjatë
Black spot grenadier

Coenagrion tenellum

Pilivesa trupkuqe, bishtagane trupkuqe
Small red damselfly

Colias hyale

Flutura e jonxhës
Pale clouded yellow

Coluber caspius

Shigjeta e gjatë, astriti, biskari, shigjetulla, gjetulla, beri
Large whip snake

Coluber gemonensis

Shigjeta e shkurtër
Balkan whip snake

Coluber najadum

Shigjeta e hollë
Dahl's whip snake

Columba livia
Pëllumbi i shkëmbit
Rock dove

Columba oenas
Pëllumbi i pyllit
Stock dove

Columba palumbus
Gugashi, guhaku, llabatani
Woodpigeon

Conger conger
Ngjala e egër, ngjala e detit, gruja, grua
European conger

Conocephalus discolor
Karkaleci antenëgjatë kokëkonik
Long-winged conehead cricket

Conus mediterraneus
Koni mesdhetar
Mediterranean cone

Copris lunaris
Brumbulli me bri i bajgave
Horned dung beetle

Coracias garrulus
Grifsha e detit, sorra e kaltër
Roller

Corallium rubrum
Korali i kuq
Red coral

Cordulegaster annulatus

Pilivesa unazaverdhë

European biddiy

Coregonus wartmanni

Trofta bojëqielli

Blue whitefish

Coreus marginatus

Çimka e lëpjetës

Dock leaf bug

Coris julis

Peshk bari brezylbertë

Mediterranean rainbow wrasse

Coronella austriaca

Gjarpri i butë

Smooth snake

Corvus corax

Korbi, korraku

Raven

Corvus cornix

Gallofi, korbi i bardhë

Hooded crow

Corvus frugileus

Korbi sqepbardhë, korbi i vogël

Rook

Corvus monedula

Sorra

Jackdaw

Coryphaena hippurus
Korifena, peshku delfin
Common dolphinfish

Coturnix coturnix
Shkurta, shkortëza
Common quail

Cotylorhiza tuberculata
Meduza lulalakër
Fried egg jellyfish

Crangon crangon
Karkalec deti i kafenjtë
Brown shrimp

Crex crex
Mbreti i shkurtës, prijësi i shkurtës
Corncrake

Crocidura suaveolens
Hundëgjati i vogël dhëmbëbardhë
Lesser white toothed shrew

Cryptocephalus violaceus
Buburreci kokëfshehur vjollcë
Violet click beetle

Ctenopharyngodon idella
Amuri i bardhë
Grass carp

Cuculus canorus
Qyqja, kukja
Cuckoo

Cucumaria planci

Trangull deti kafenjtë, shulajkori i kafenjtë

Brown sea cucumber

Culex pipiens

Mushkonja

Mosquito

Cyclope neritea

Ruazë e detit

Thumb nail

Cygnus cygnus

Mjellma qafëdrejtë, mjellmja, mjellna, shqitëza

Whooper swan

Cygnus olor

Mjellma me xhungë

Mute swan

Cynthia cardui

Flutura e gjëmbave

Painted lady

Cyprinus carpio

Krapi, pendëkuqi, krapuliq, lakeç

Common carp

Cyrtodactylus cotschyi

Geku i Koçit, hardhuca e shtëpisë laramane, zhapiu me kthetra

Cotschy's gecko

D

Dactylopterus volitans
Peshku gjel fluturues, gishtflatorri
Flying gurnard

Dacus oleae
Miza e ullirit
Olive fruit fly

Dalatias licha
Djalli i natës
Kitefin shark

Dalophis imberbis
Ngjalëgjarpër e gjymtuar, bisha e detit
Armless seasnake eel

Dardanus arrosor
Gaforre heremite
Deep water hermit crab

Dasyatis centroura
Neshtelije, trigoni bishtgjatë
Raughtail stingray

Dasyatis pastinaca
Shkotërra, trigoni, bishtmiu, bishtmini
Common stingray

Decticus albifrons
Karkaleci antenëgjatë ballëbardhë
White-faced bush cricket

Decticus verrucivorus
Karkaleci antenëgjatë lythor
Wart-biter grasshopper

Delichon urbica
Dallëndyshja kërbishtbardhë, dallëndyshja gushëbardhë
House Martin

Delphinus delphis
Delfini i zakonshëm
Common dolphin

Dendrocopos leucotos
Qukapiku larosh shpinëbardhë
White-backed woodpecker

Dendrocopos major
Qukapiku larosh kurrizbardhë, qukapiku i madh
Great spotted woodpecker

Dendrocopos minor
Qukapiku i vogël larosh
Lesser spotted woodpecker

Dendrocopos syriacus
Qukapiku i zakonshëm larosh, bredrunja, sqepadruthi, shqepadruri, qokaçi
Syrian woodpecker

Dentex dentex
Dentali, dhëmbaçi, sinagridhja
Common dentex

Dentex gibbosus

Dentali i trëndafiltë, dentali ballëgungaç

Pink dentex

Dentex macrophthalmus

Dentali symadh

Large eye dentex

Dermochelys coriacea

Breshka e detit lëkurore

Leathery turtle

Deroceras reticulatum

Ligaveci rrjetor

Reticulated slug

Dicentrarchus labrax

Levrek, lavraku, bafa (femra), lapri (levrek i vogël)

European seabass

Dicentrarchus punctatus

Levrek pikalosh

Spotted seabass

Diodora graeca

Kupa e vrimuar europiane

Europaen keyhole limpet

Diodora italica

Kupa e vrimuar italiane

Italian keyhole limpet

Diplodus annularis

Sargu bishtzi, spari bishtzi

Annular seabream

Diplodus cervinus
Sargu zebër, sargu buzëmadh
Zebra seabream

Diplodus puntazzo
Sharani, shpici
Sharpsnout seabream

Diplodus sargus
Sargu i zakonshëm, sargu i bardhë
White seabream

Diplodus vulgaris
Sargu me dy shirita të zi
Common two-banded seabream

Dociostaurus maroccanus
Karkaleci maroken
Maroccan locust

Dolycoris baccarum
Gjoci, goci, gjonthi
Hairy shieldbug

Donax trunculus
Midhja buzësharrë
Common wedge shell

Dorcus parallelipedus
Kacadren i vogël
Lesser stag beetle

Dosinia lupinus
Artemisja e lëmuar
Smooth artemis

Dreissena blanci
Vasku, vasku trefaqesh
Greece threefaced mussel

Dromia personata
Gërthia e sfungjerëve
Sponge crab

Drosophila melanogaster
Miza e uthullës
Yellow parmace fly

Dryocopus martius
Qukapiku i zi
Black woodpecker

Dryomys nitedula
Gjumashi i pyllit
Forest dormouse

Dytiscus marginatus
Brumbulli zhytës
Great diving beetle

E

Echelus myrus
Ngjala qullamane
Painted eel

Echiichthys vipera
Ranxha viper, dreqi i vogël i detit
Lesser weever

Echinaster sepositus

Ylli i kuq

Red starfish

Echinocardium cordatum

Iriqi zemër i detit

Heart urchin

Echinorhinus bruscus

Peshkaqeni me ferra

Bramble shark

Echinus acutus

Iriq deti me gjëlpëra

Longe-spined sea urchin

Ectobius sylvestris

Bumellëza e pyllit

Forest cockroach

Egretta alba

Çafka e bardhë e madhe, çafka e bardhë e madhe, gatëza e bardhë e madhe, gata e bardhë e madhe, çapkëbardha e madhe, çajma e bardhë e madhe

Great white egret

Egretta garzetta

Çafka e bardhë e vogël, çapka e bardhë e vogël, gatëza e bardhë e vogël, gata e bardhë e vogël, gelca e bardhë e vogël, çapkëbardha e vogël, çajma e bardhë e vogël

Little egret

Elaphe longissima

Bolla e shtëpisë, breva

Aesculapian snake

Elaphe quatuorlineata

Bolla me katër vija, bollëshordja, kastroqi, sovali
Four-lined snake

Elaphe situla

Bolla laramane, bolla leopard
Leopard snake

Eledona moscata

Oktapodi me aromë
Musky octopus

Emberiza cia

Cerla e malit, fuga e malit
Roch bunting

Emberiza cirrus

Cerla gushëgjelbër, fuga gushëgjelbër
Cirl bunting

Emberiza citrinella

Cërla verdhashe, fuga verdhashe
Yellohammer

Emberiza hortulana

Cerla e kopshtit, fuga e kopshtit
Ortolan bunting

Emberiza melanocephala

Cerla kokëzezë, fuga kokëzezë
Black headed bunting

Emberiza schoeniclus

Cërla e kallamishteve, fuga e kallamishteve
Reed bunting

Emys orbicularis

Breshkujca, breshkujësja, breshkujca europiane
European pond terrapin

Engraulis encrasicolus

Açuga, gavroja, inçuni
European anchovy

Ensis ensis

Midhja shpatë
Small sword razor

Ensis minor

Midhja biçak
Jackknife clam

Eobania vermiculata

Kërmilli makaron
Chocolate-band snail

Ephemera vulgata

Ditëshkurta
Brown may fly

Epicometis hirta

Buburreci lulengrënës leshtak, zhuzhaku lulengrënës leshtak,
lulengrënësi leshtak, leshtaku lulengrënës
Rose chafer beetle

Epilachna chrysomelina

Pikaloshja e bostaneve, mollëkuqja e bostaneve
Twelve-spotted melon beetle

Epinephelus aeneus
Kerni vijabardhë, kermi vijabardhë
White grouper

Epinephelus alexandrinus
Kerni i artë
Striped grouper

Epinephelus caninus
Kerni me dhëmbë
Dogtooth grouper

Epinephelus guaza
Kerni i errët, kermi
Dusky grouper

Epitonium commune
Kërmill si shkallë
Common wentletrap

Eptesicus serotinus
Lakuriqi i natës serotinë
Serotine bat

Erebia medusa
Flutura kaçurrele pyllit
Woodland ringlet

Erinaceus concolor
Iriqi, eshi
Eastern hedgehog

Eriphia verrucosa
Gërthia me lythe, gërthia helmuese e bregut
Spiny crab

Erithacus rubecula

Gushëkuqi, gushari, gushali, gushëspeci, gjinokuqi, gushakuqi,
canakuqi, grykakuqi

Robin

Eryx jaculus

Bolla e rërës

Sand boa

Etmopterus spinax

Peshkaqeni barkzi

Velvet belly lantern shark

Eudontomyzon stankokaramani

Kavalli i Drinit

Drini brook lamprey

Eugomphodus Taurus

Peshkaqen i egër

Sand tiger shark

Eunicella cavolinii

Gorgonia e verdhë

Yellow gorgonia

Eurydema oleracea

Tartabiqi i kryqoreve, çimka e kryqoreve

Cabbage bug

Eurydema ornata

Çimka e lakrës, breshka e lakrës

Red cabbage bug

Eurygaster austriacus

Çimka e drithrave, çimka austriake

Wheat bug

Euscorpius tergestinus

Hagrepi, akrepi, grepi, grepsi, karrivoja, zgardivoja, sfurku,
përçollaku

Skeged scorpion

Euthynnus alletteratus

Toni i vogël

Little tunny

Exocoetus volitans

Peshk dallëndyshe, peshk fluturues, dallëndyshe deti, dallnysh
deti

Tropical two-wing flying-fish

F

Falco biarmicus

Skifteri mesdhetar

Lanner

Falco cherrug

Skifteri i gjuetisë

Saker

Falco columbarius

Skifteri i vogël

Merlin

Falco eleonorae

Skifteri mbretëror, skifteri i murrmë
Eleonora's falkon

Falco naumanni

Skifteri kthetraverdhë
Lesser kestrel

Falco peregrinus

Krahëthati, krahathata, krahathadra
Peregrine

Falco subbuteo

Skifteri i drurëve
Hobby

Falco tinnunculus

Skifteri, skylferi, skyferi, skilferi, skilfyer, aqyfleri, sokoli,
kaçubeti, petriti, shahini, shahimi (kthetrazi), fajkua, falkoni,
fakjonja, sokol i dobishëm, sokoli i erës
Kestrel

Falco vespertinus

Skifteri këmbëkuq
Red footed falcon

Fasciolaria lignaria

Kërmilli tulipan i detit
Mediterranean tulip shell

Felis sylvestris

Macja e egër
Wild cat

Ficedula albicollis
Mizëkapësi qafëbardhë
Collared flycatcher

Ficedula hypoleuca
Mizëkapësi i zi, mizëkapësja kokëzezë
Pied flycatcher

Ficedula semitorquata
Mizëkapësi krahëvijosh
Semi-collared flycatcher

Forficula auricularia
Gërshërëza e veshit, kabishti i veshit, lugveshëza, veshëza
European earwig

Formica rufibarbis
Milingona qimekuqe, thnegla qimekuqe, kacagjeli qimekuq,
dheuli qimekuq
Red-barbed ant

Fringilla coelebs
Avdosa, zogu i borës, borësi, borci, boraku, zboraku, finku
Chaffinch

Fringilla montifringilla
Zboraksi i malit, zogu i borës i malit, borcaku, borci i bjesh-
kve
Brambling

Fulica atra
Bajza, bajukla, bajuka
Coot

Fusinus rostratus
Kërmilli boshtor mesdhetar
Mediterranean fusin

G

Gaidropsarus mediterraneus
Motelja mesdhetare
Shore rockling

Galba truncatula
Kërmilli i vogël i kënetës
Dwarf pond snail

Galeodea echinophora
Kërmilli zile me gunga
Mediterranean spiny bennet

Galeorhinus galeus
Peshk qen
Tope shark

Galerida cristata
Dervishi, qolja, larusha me kësulë, kësulëri, çobani, çafkëlorja, çafkkulorja, kaçulja, kaçulidhi, çobani
Crested lark

Galeus melastomus
Gojëziu, macja gojëzezë
Blackmouth catshark

Gallinago gallinago
Shapka e ujit, shepka e ujit, shepkujca, shaptorja e ujit
Snipe

Gallinago media

Shapka e madhe e ujit, shepka e madhe e ujit

Great snipe

Gallinula chloropus

Pula e ujit, bariu

Moorhen

Gambusia affinis

Barkuleci, peshku i mushkonjave

Mosquitofish

Gammarus balcanicus

Mitriku i liqenit

Balcanic shreder

Garrulus glandarius

Grifsha, grizhlemza, çota

Jay

Gasterosteus aculeatus

Gjëmbaçi, peshk koçkuni

Three spined stickleback

Gavia arctica

Nori gushëzi, norusha

Black throated loon

Gavia immer

Nori i madh

Great loon

Gavia stellata

Nori gushëkuq

Red throated loon

Gelochelidon nilotica
Dallëndyshja sqeptrashë e detit
Gull-billed tern

Geotrupes vernalis
Brumbulli dimëror
Spring dumbledor

Geris paludum
Çimka skijatore e ujit
Pond skater

Glaphyrus vulpes
Kandërdhelpra
Bumble bee scarab beetle

Glareola pratincola
Dallëndyshja e detit, bishtdallëndyshe
Collared pratincole

Glis glis
Gjeri, geri, giri, gjumashi i majmë i pyllit
Fat dormouse

Glomeris marginata
Mokra
Common ball millipede

Glossanodon leioglossus
Argjendina gjuhëlëmuar, argjendina e thellësive, symadhe
Small toothed argentine

Glossus humanus
Midhja e madhe zemër
Heart cockle

Glycymeris glycymeris

Bajame deti

Dog cockle

Gnaptor spinimanus

Trupziu

Darkling beetle

Gobio gobio

Mrena njëmustakore

Gudgeon

Gobio ohridanus

Mrena e Ohrit, mrenka

Ohrid's gudgeon

Gobius bucchichi

Burdullaku

Bucchich's goby

Gobius niger

Burdullaku i zi, gobiti i zi

Black goby

Gobius paganellus

Burdullaku i shkëmbit

Rock goby

Gomphocerus sibiricus

Karkaleci siberjan

Siberian locust

Goneplax rhomboids

Gërthia trapezoide

Angular crabs

Gonepteryx Cleopatra

Flutura kleopatra

Cleopatra butterfly

Gonepteryx rhamni

Flutura e gjerdheve, flatërkandorja e zoglës

Brimstone

Graphosoma italicum

Çimka italiane

Pyjamawant

Graphosoma lineatum

Çimka kuq e zi

Red-black shield bug

Graphosoma semipunctatum

Çimka pikaloshe

Brightly-colored stink bug

Grus grus

Krilla, korrila, kurrila, kojrrila, toja

Common crane

Gryllotalpa gryllotalpa

Doska e dheut, dosëza e dheut, arçi, bushtra, bushtërza, bush-tresa, këlyshi i dheut, bugjeku

European mole cricket

Gryllus campestris

Bulkthi i arave, torrkaçi

Field cricket

Gymnura altavela
Aeroplankë, raja flutur therëse
Spiny butterfly ray

Gypaetus barbatus
Shkaba mjekroshe
Bearded vulture

Gyps fulvus
Shkaba, gabonja, gaboja, zhgabonja, gaba, kobëza kokëbar-
dhë, skjepnoja
Griffon vulture

Gyrinus notator
Gangra, verla mbi ujë
Whirligig beetle

H

Haematopus ostralegus
Laraska e detit
Oystercatcher

Haliaeetus albicilla
Shqiponja e detit, shqipja e detit
White tailed eagle

Halicolenus dactylopterus
Shkerpi i thellësive
Rockfish

Haliotis lamellose
Kërmilli vesh
Sea ear

Hediste diversicolor
Shumëketëshi i lagunave
Ragworm

Helicigona byshekensis
Kërmilli i shkëmbinjve të Byshekut
Byshek rock snail

Helicigona inflata
Kërmilli i shkrepave të Alpeve
Alp rock snail

Helicigona pouzolzii
Kërmilli i shkrepave dinarike
Dinaric rock snail

Helicigona serbica
Kërmilli i shkrepave sërbe
Serbian rock snail

Helicigona tujana
Kërmilli i shkrepave të Tujanit
Tujan rock snail

Helix aspersa
Kërmilli i vreshtave laraman, kërmilli i kopshteve
Common garden snail

Helix lucorum
Kërmilli i vreshtave me rripa, kërmilli i pyllit
Turkish snail

Helix secernenda
Kërmilli i vreshtave dalmatin
Dalmatian snail

Hemidactylus turcicus

Geku turk, hardhuca e shtëpisë, zhapiu me ventuza, tambluci
Turkish gecko

Hepranchias perlo

Peshkaqeni me dhëmbë
Bluntnose sevengill shark

Hexanchus griseus

Peshkaqeni kokështypur
Bluntnose sixgill shark

Hexaplex trunculus

Kërmilli guaskëpurpur
Short whelk

Hieraetus fasciatus

Shqiponja si fajkua, shqiponja bishtvijëzuar
Bonelli's eagle

Hieraetus penatus

Shqiponja e vogël, shqiponja shkurtabiqe
Booted eagle

Himantopus himantopus

Kalorësi, fisnikorja këmbëkuqe
Black winged stilt

Hipoderma bovis

Koshza, korbolec
Ox warble-fly

Hippobosca equina

Mizë kali
Horse fly

Hippocampus hippocampus
Kali i detit turishkurtër
Short-snouted seahorse

Hippocampus ramulosus
Kali i detit turigjatë
Long-snouted seahorse

Hippolais olivetorum
Përqeshësi i madh i ullinjve
Olive tree warbler

Hippolais pallida
Përqeshësi i vogël i ullinjve
Olivaceous warbler

Hippospongia communis
Sfungjeri me zgavra
Honeycomb sponge

Hirudo medicinalis
Ushujza e rëndomtë, ushujzë dermani, shushunja e rëndomtë,
pjavica
Medicinal leech

Hirundichthys rondeletti
Peshk-dallëndyshe pendëzezë
Blackwing flyingfish

Hirundo daurica
Dallëndyshja kërbishtkuqe
Red rumped swallow

Hirundo rustica

Dallëndyshja bishtgërshërë, dallandyshja bishtgërshanë
Swallow

Holandriana holandrii

Kërmilli me kurorë
Coroned snail

Holothuria tubulosa

Trangull deti si fugë, shulajkori fugë
Cotton spinner

Homarus gammarus

Gaforrja e madhe europiane, langusta, homari
European lobster

Huso huso

Blini i Europës, blini i madh, blini turishkurtër
Beluga sturgeon

Hydra oligactis

Hidra kafe
Brown hydra

Hydrobates pelagicus

Zgalemi i vogël
British storm-petrel

Hydrous piceus

Brumbulli ujëdashës
Great silver beetle

Hyla arborea

Bretkoca e pemëve
Common tree frog

Hypophthalmichthys molitrix

Ballëgjëri i bardhë

Silver carp

Hypophthalmichthys nobilis

Ballëgjëri laraman

Bighead carp

I

Icerya purchasi

Pambukorja e agrumeve

Icerya scale insect

Ilia nucleus

Gërthia arrë

Nut-crab

Inachis io

Flutura “syblu”

Peacock butterfly

Inachus dorsettensis

Gërthia akrep-merimangë

Scorpion spider crab

Iphiclides podalirius

Gjelamani

Scarce swallowtail

Isodontia splendidulus

Grethi belhollë i karkalecave

Grass carrying wasp

Isophya speciosa
Puçibaba e gjelbërt
Green bush cricket

Isurus oxyrinchus
Peshkaqen tonil, peshkaqen turishkurtër
Shortfin mako shark

Iulus terrestris
Horza
Chocolate millipede

Ixobrychus minutus
Gakthi i vogël
Little bittern

J

Jynx torquilla
Qafëdredhësi, thënegëIngrënësi kokëperdredhur, teshka
Wryneck

K

Knipowitschia panizzae
Burdullaku i vogël
Lagoon goby

L

Labidura riparia

Gërshtërëza bishtdallëndyshe, kabishti bishtdallëndyshe
Shore earwig

Labrus bimaculatus

Peshk pallua
Cuckoo wrasse

Labrus merula

Buzoçi i zi
Brown wrasse

Labrus viridis

Peshk jeshil, peshk bari, labri, laramani
Green wrasse

Lacerta agilis

Zhapiu i shpejtë
Sand lizard

Lacerta trilineata

Zhapiu me tri vija
Balkan green lizard

Lacerta viridis

Zhapiu i gjelbër, zhapiku i gjelbër, çapini
Green lizard

Lacerta vivipara

Zhapiu këlyshlindës, hardhuca këlyshlindëse
Viviparous lizard

Lamna nasus

Tonil

Porbeagle

Lampetra planeri

Kavalli i përroit

Brook lamprey

Lampyrus noctiluca

Xixëllonja, bukureza, bukureja, cilivilja, çiklorja e natës, çikë-
vera, çika e natës, gacullina, gacëngjigja, vezullonja, vezu-
llorja

Common glow-worm

Lanius collurio

Larashi kurrizkuq, tokmaku, çajma kurrizkuqe, tamalari, squp-
trasha

Red backed shrike

Lanius exubitor

Larushi i madh i përhimtë, laramani i madh, larashi i madh i
përhimtë, çajma e madhe

Great grey shrike

Lanius minor

Larushi i vogël, laramani i vogël, larashi i vogël ballëzi, çajma
e vogël

Lesser grey shrike

Lanius senator

Larashi kokëkuq, larushi kokëkuq, laramani kryekuq, çajma
kokëkuqe

Woodchat shrike

Larus cachinnans

Pulëbardha, pulëbardha këmbëverdhe

Yellow legged gull

Larus canus

Pulëbardha e përhimtë

Common gull

Larus genei

Pulëbardha rozë, pulëbardha sqepgjatë

Slender billed gull

Larus melanocephalus

Pulëbardha kokëzeze

Mediterranean gull

Larus minutus

Pulëbardha e vogël

Little gull

Larus ridibundus

Pulëbardha e rëndomtë

Black headed gull

Lema melanopus

Ushunjëza e drithrave

Cereal leaf beetle

Lepadogaster lepadogaster

Peshku sqepok

Cornish sucker

Lepas anatifera

Gaforre me guaskë sqeprose

Common goose barnacle

Lepidopus caudatus

Jatagani i argjentë, peshku flamur

Silver scabbardfish

Lepidorhombus boscii

Rombi i ashpër katërpikësh, peshk tulle

Fourspotted megrim

Lepidorhombus wiffiagonis

Rombi i ashpër verdhacak

Megrim

Lepidotrigla cavillone

Peshkgjel luspëmadh

Large scaled gurnard

Lepisma saccharina

Peshkthi

Silverfish

Lepomis gibbosus

Sharoku diellor, sharoku laraman, peshku diell

Pumpkinseed

Leptidea sinapis

Flutura e sinapit

Wood white

Leptinotarsa decemlineata

Buburreci i patates

Colorado patato beetle

Lepus europaeus

Lepuri i murmë

Brown hare

Lestes dryas
Pilivesëza e xunkthave
Emerald spreadwing

Lethenteron zanandreae
Kavalli i Moraçës
Po brook lamprey

Lethocerus griseus
Çimka gjigante e ujit
Giant water bug

Leucoraja fullonica
Raxha gjëmbore
Shagreen ray

Libelloides macaronius
Pilivesakja me ngjyra
Ascalaphus owlfly eye

Libellula depressa
Pilivesa ndjekëse
Chaser dragonfly

Lichia amia
Lojba, lica, glica
Leerfish

Lima lima
Midhja lime
File shell

Limax cinereoniger
Ligaveci i zi i frashërit
Ash-black slug

Limax flavus
Ligaveci i verdhë
Great yellow slug

Limax maximus
Ligaveci i madh, ligaveci tiger
Tiger slug

Limosa lapponica
Gjelëza e madhe bishtvijëzuar
Bartailed godwit

Limosa limosa
Gjelëza e madhe bishtzezë, gjelaci bishtzi
Black tailed godwit

Liocarcinus depurator
Gërthia këmbëlopatë blu
Blue-leg swimming crab

Lipophrys basiliscus
Peshk bari
Zebra blenny

Lipophrys pavo
Peshk guri pallua, bukurina, marxhani
Peacock blenny

Lithobius forficatus
Moknorja
Brown centipede

Lithognathus mormyrus
Murra, murra me rripa
Striped seabream

Lithophaga lithophaga

Midhja hurmë

European data mussel

Liza aurata

Veshflorini, veshari, gasturi

Golden grey mullet

Liza ramado

Qefulli i vjeshtës, kokdhani, qerfi, kryeprefiti, kryegjati, kryeholli, vijoçi

Thinlip mullet

Liza saliens

Gasturi, veshverdhi

Leaping mullet

Locusta migratoria

Karkaleci migrues

African migratory locust

Locustella fluviatilis

Bilbilthi i lumit

River warbler

Locustella luscinioides

Bilbilthi

Savi's warbler

Loligo vulgaris

Kalmari, kallamari, lignja, ulignja

European squid

Lophius budegassa

Zhaba e detit, hënëza e detit e verdhë

Black-bellied angler

Lophius piscatoris

Peshkatari, zhaba peshkatare, hanëza, hanza, hënëza e detit,
peshk çatrafili

Angler

Loxia curvirostra

Sqepkryqi

Crossbill

Lucanus cervus

Kacadreni, kacadrei, brekazi

Stag beetle

Lucilia caesar

Miza e kadavrave

Greenbottle

Lullula arborea

Drenja

Woodlark

Luria lurida

Medaljoni i përflaktë

Lurid cowry

Luscinia megarhynchos

Bilbili, bylbyli

Nightingale

Lutra lutra

Vidra, lundërza, lundra, lunza, kajka

Common otter

Luvarus imperialis

Peshku imperator, peshk zumpare

Luvar

Lycaena dispar

Fluturz e bakërt e madhe

Large copper

Lycaena phlaeas

Fluturz e bakërt e vogël

Small copper

Lygus pratensis

Tartabiqi i fushës, çimka e fushës

Tarnished plant bug

Lymnaea stagnalis

Kërmilli i madh i kënetës

Great pond snail

Lymnocyrtus minimus

Shapka e vogël e ujit, shepka e vogël e ujit, shepkujca e vogël

Jack snipe

Lynx lynx

Rrëqebulli, lulqerbulli, luqerbulli, lubardha

Lynx

Lyrister plebejus

Gjinkalla e madhe

Tibicien cicada

M

Macropodia longipes

Gërthia merimangë

Spider crab

Macroramphosus scolopax

Peshku trompetë

Longspine snipefish

Mactra corallina

Midhja lugë

Rayed trough clam

Maja squinado

Gërthia e madhe me gjëmbe

Spiny spider crab

Malpolon monspessulanus

Biroja, bavroja, blauroja

Montpellier snake

Maniola jurtina

Flutura kafe e livadheve

Meadow brown

Mantis religiosa

Murgeshëza, kalë shtrigash

European mantis

Martes foina

Shqarrthi, kunadhja gushëbardhë

Beach marten

Martes martes

Zardafi, kunadhja gushëverdhë, kuna, kuni

Pine marten

Marthasterias glacialis

Ylli i madh me papilla

Spiny starfish

Mauremys caspica

Breshkujca qafëshiritore

Stripe-necked terrapin

Medorippe lanata

Gërthia me push

Wollenchild

Megalobrama terminalis

Pëllëmbëza e zezë, pëllëmbëza e zezë e Amurit

Black amur bream

Melanargia galathea

Flutura e mermertë

Marbled white

Melanitta nigra

Rosa e zezë, rosa kadife

Common scotter

Melanocorypha calandra

Çerdhukla, çerdhukulla

Calandra lark

Melanogryllus desertus

Bulkthi i djerrinave

Desert cricket

Meles meles

Vjedulla, baldosa, dosëbala, bala

Badger

Melitaea cinxia

Flutura shumëngjyrëshe

Glanville fritillary

Melolontha melolontha

Zhuzhaku i majit, idhnaku

Common cockchafer

Menopon pallidum

Pulizi

Chicken louse

Mergus albellus

Zhytësi i vogël laraman, zhytës i bardhë

Smew

Mergus merganser

Zhytësi i mesëm

Goodsander

Mergus serrator

Zhytësi i mesëm me çallmë

Red breasted merganser

Merluccius merluccius

Merluci, bakalaku

European hake

Merops apiaster

Babilja, babili, bregca, brojca, griklla, peligorga, zarigoga,
bletorja e verdhë
Bee eater

Messor structor

Milingona e zezë, thnegla e zezë, miza e dheut e zezë
Fourmis

Microchirus ocellatus

Gjuhëza me katër sy
Foureyed sole

Microchirus variegates

Gjuhëza me breza, gjuhëza kurriztrashë, gjuhëza brezake
Thickback sole

Microcondylaea compressa

Midhje lumi dhëmbëvegjel
Small tooth river mussel

Microcosmus sulcatus

Fik deti
Sea fig

Micromesistius poutassou

Merluci blu, merluci tripëndësh
Blue whiting

Microstoma microstoma

Argjendina e hollë, symadhja e hollë
Slender argentine

Miliaria calandra

Cërla e zakonshme, cerla, fuga gretha

Corn bunting

Milvus migrans

Qifti zeshkan, huta e zezë bishtgërshërë, kaçubeti zeshkan,
kaçubeti zeshkan

Black kite

Milvus milvus

Qifti i kuqremtë, huta e kuqremtë bishtgërshërë, kaçubeti i
kuqremtë

Red kite

Miniopterus schreibersii

Lakuriqi i natës i Shraibersit

Schreiber's bat

Mobula mobular

Lopa e detit, djalli i detit

Devil fish

Mola mola

Peshku hënë, peshkahana, hana

Ocean sunfish

Monacha cartusiana

Kërmilli hartë

Carthusian snail

Monachus monachus

Foka e Mesdheut

Mediterranean monk

Monochirus hispidus

Gjuhëza lekurore

Whiskered sole

Monodonta turbinata

Kërmilli i detit me zedef, kërmilli zare

Turbinate monodont

Monticola solitarius

Tusha blu, mëllënja e kaltërt

Blue rock thrush

Motacilla alba

Bishtlëkundësi i bardhë, bishtundësi i bardhë, bishtatunda, bishtdylberja e bardhë, dylmerja e bardhë, delmerja, zogu i dhenëve, bishtgjata e bardhë, trinka e bardhë, çobanka, trinca, cingra, çiriçinga, tundbishtja, zogdhenësh

Pied wagtail

Motacilla cinerea

